VENDIM
Nr.376, datë 31.5.2005

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.88, DATË 1.3.1993 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E ZONAVE, QË KANË PËRPARËSI ZHVILLIMIN E TURIZMIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 2 të ligjit nr.7665, datë 21.1.1993 "Për zhvillimin e zonave, që kanë përparësi turizmin", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 1 të vendimit nr.88, datë 1.3.1993 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto shtesa:

a) Në shkronjën "A", në paragrafin "Territoret nga Pishë Poro në Zvërnec, ato kufizuese të gjirit të Vlorës", shtohen fjalët "…, përjashtuar zonën e Akernisë.".

b) Në shkronjën "B", në paragrafin "Bregu i liqenit të Butrintit, në rrethin e Sarandës", shtohen fjalët "…, përjashtuar zonën e Ultësirës së Vrinës dhe fushën e Vurgut.".

2. Ngarkohet Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano